

Fakte bazë

Shefi i Misionit: **Yves de Kermabon**



Zyrat qendrore: Prishtinë

Forca e Misionit: 1900 staf ndërkombëtar dhe 1100 staf vendor

Mandati: përkujdesja, mbikqyrja dhe këshillimi i autoriteteve lokale në fushën e sundimit të ligjit. Disa pushtete ekzekutive ruhen.

Buxheti i Misionit: 205 milion euro për 16 muajt e parë.

Të përgjithshme: EULEX-si ka një zinxhir të unifikuar komandues të BE-së në Bruksel dhe punon brenda kornizës së Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit.

Shtetet kontribuuese: Pjesa më e madhe e vendeve të BE-së si dhe Norvegjia, Zvicra, Turqia, Kroacia dhe Shtetet e Bashkuara. Të tjerët mund ti bashkohen.

"Mbështetja e pronësisë vendore"



EULEX KOSOVO

Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë

Të dhënat: Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) është misioni më i madh civil i lëshuar ndonjëherë nën autoritetin e Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP). Misioni bazohet në një vendim të vendeve anëtare të BE-së të marrë në shkurt të vitit 2008. EULEX-si u bë operacional më 9 dhjetor 2008 dhe do të jetë plotësisht i dislokuar nga fundi i dimrit.

Objektivi: Synimi kryesor është të ndihmojë dhe mbështesë institucionet që merren me sundimin e ligjit, autoritetet gjyqësore dhe agjensitë e sundimit të ligjit në përparimin e tyre drejt vetë-mbajtjes dhe llogari-dhënies dhe në zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të një sistemi shumë-etnik të pavarur të drejtësisë, të një policie shumë-etnike dhe të shërbimit doganor.

Metoda: Misioni perceptohet si një përpjekje e përbashkët me autoritetet lokale, në përputhje me parimin e pronësisë vendore. Kjo do të bëhet përmes përkujdesjes, mbikqyrjes dhe këshillimit në të gjitha fushat që lidhen me sundimin e ligjit. EULEX-si do të ushtrojë disa përgjegjësi ekzekutive në fusha specifike të kompetencave.

Prioritetet: Ndërkohë që EULEX-si do të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me sundimin e ligjit, ka një numër fushash që do të kenë përparësi. Ato përfshijnë: krimet e luftës, korrupsionin, krimin e organizuar, krimet ndër-etnike, pastrimin e parave, terrorizmin dhe çështjet që lidhen me pronat.

www.eulex-kosovo.eu